

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Avionët luftarakë italianë ngrihen në fluturim pas shkeljes së hapësirës ajrore lituaneze nga forcat ajrore ruse
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/avionet-luftarake-italiane-ngrihen-ne-fluturim-pas-shkeljes-se-hapesires-aj-i586779
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:55:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 20:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	de0ecb0c15e13212a094a3b9f55dd22c5e181ed8a4b47407353262b45b9e0bbb
TEKSTI	c52325a852afccf476a4de372151aa3070861b446606e26bef6be0f8d4ca61ff
PAMJA	b45409ddc0ac01fbdf6b34bfc12bec3eda3eee8a2faa55cb0adf7812087b34be

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	75c47b981b6b9e1b4a8131b3a3fe7ba172d6a061f18a71b55b6d841a0b42eb26
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/75c47b981b6b9e1b4a8131b3a3fe7ba172d6a061f18a71b55b6d841a0b42eb26>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Avionet luftarakë italianë ngrihen në fluturim pas shkeljes së hapësirës ajrore lituaneze nga forcat ajrore ruse "Syte" ruse mbi Amerikën, 14 satelite spiune mbi bazën e S fundit](#)

Avionët luftarakë italianë ngrihen në fluturim pas shkeljes së hapësirës ajrore lituaneze nga forcat ajrore ruse



17 Shtator 2026, 22:50Bota TEMA



Një incident i ri ajror është regjistruar në krahun lindor të NATO-s, ku dy avionë luftarakë Eurofighter F-2000 të Forcave Ajrore Italiane u ngritën me urgjencë pasditen e sotme nga baza e Šiauliai-t në Lituani. Ndërhyrja e Task Forcës Ajrore "Baltic Thunder III" erdhi si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj shkeljes së hapësirës ajrore lituaneze nga dy avionë luftarakë rusë. Operacioni ushtarak u koordinua përmes Qendrës së Operacioneve Ajrore të Kombinuara të NATO-s me qendër në Uedem të Gjermanisë.

[Ngjarja](#) vjen në një moment përshkallëzimi të tensioneve diplomatike e ushtarake në rajon. Duke komentuar provokimet e përsëritura të Moskës, kryeministrja italiane Giorgia Meloni deklaroi se veprimet e Rusisë synojnë të shmangin vëmendjen nga vështirësitë në front.

"Provokimet e Moskës po shtohen sepse Putini duhet ta largojë vëmendjen nga një situatë lufte që nuk po shkon siç kishte premtuar Putini, duke kërkuar një përshkallëzim me Evropën. Nuk duhet të reagojmë ndaj provokimeve; kjo do t'i sillte më shumë doli Rusisë sesa Evropës.", tha Giorgia Meloni.

Sulme ndaj anijeve civile dhe bombardime në Kiev

Në një tjetër zhvillim dramatike në Detin e Zi, një dron rus goditi një anije civile me flamur të Tanzanisë që po lundronte drejt një porti ukrainas, duke lënë të vdekur kapitenin e saj dhe duke plagosur tre anëtarë të ekuipazhit. Autoritetet ukrainase denoncuan sulmet sistematike të Rusisë ndaj infrastrukturës detare dhe mjeteve tregtare ndërkombëtare.

Paralelisht, gjatë natës, Kiev i u përball me një valë tjetër bombardimesh me raketa e dronë. Administrata ushtarake e kryeqytetit lëshoi alarmin e kuq pas goditjes së ndërtesave të banimit, shkollave dhe infrastrukturës hekurudhore, ku mbetën të plagosur 18 persona, mes të cilëve dy fëmijë. Nga ana tjetër, në rajonin rus të Yaroslavl-it, një sulm masiv me 65 dronë ukrainas dëmtoi një rafineri naftë, duke shkaktuar zjarre e dëme materiale. Polonia ngre avionët luftarakë pas zbulimit të një droni rus

Tensionet janë përhapur edhe në kufirin polak, ku Forcat Ajrore të Varshavës ngritën në fluturim mjetet e tyre ushtarake dhe vunë në gatishmëri sistemet

mbrojtëse pas zbulimit të një droni reaktiv rus që po i afrohej kufirit. Zëdhënësi i Komandës Operacionale, Jacek Goryszewski, konfirmoi se mjeti shpërtheu rreth 4 kilometra larg kufirit pasi u neutralizua.

Edhe pse fluturimet në aeroportet e Lublinit dhe Rzeszów-it u pezulluan përkohësisht si masë paraprake, zv.ministri i Mbrojtjes Cezary Tomczyk sqaroi se nuk u regjistrua asnjë shkelje e drejtpërdrejtë e hapësirës ajrore polake. Ndërkohë, në rrafshin diplomatik, Ministri i Jashtëm ukrainas Andrii Sybiha njoftoi se po përgatitet takimi mes Presidentit Zelensky dhe Presidentit Trump në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ku synohet hapja e rrugës për një armëpushim në sektorin e energjisë dhe në Detin e Zi.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"Sytë" rusë mbi Amerikën, 14 satelitë spiunë mbi bazën e SHBA para sulmit iranian

22:40 Bota

Erdogan për anëtarësimin e Turqisë në BE: Nuk është më prioriteti ynë, ata do të humbasin, jo ne

22:30 Bota

[Pesë të vrarë nga 'lufta me dronë' mes Arabisë Saudite dhe rebelëve Houthi](#)

22:10 Bota

Konflikti me Iranin, Trump: SHBA-ja ka mbrojtur vendet e Gjirit!

21:20 Bota / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.